



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.725/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci kryesues, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi-anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Klllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Komunën e Klllokotit, kundër vendimit Nr. 2858-2021 të datës 28.10.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të shitblerjes së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** pjesërisht i bazuar apeli A.nr.725/2021 i datës 29.10.2021, i paraqitur nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Klllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Klllokot, ndërsa Subjektit Politik Lista Serbe, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 8,100.00 euro (tetë mijë e një qind), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021.

**II. DETYROHET** subjekti politik Lista Serbe, që gjobën e shqiptuar si në pikën -1- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënimin e dënimit shtesë.

**III. REFUZOHET** e pa bazuar pjesa e apelit të kandidatit për kryetar të Komunës së Klllokotit Strahinja Spasiq, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me të cilën ka kërkuar që të anulohet rezultati përfundimtar i shpallur me vendimin me Nr. 2858/2021 i datës 28.10.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), dhe të de certifikohet Subjekti Politik Lista Serbe, nga Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

## A r s y e t i m

PZAP-i më datë 29.10.2021, ka pranuar një apel nga Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Klllokot, në të cilën pretendohet se menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve lokale nga ana e KQZ-së, ka pasur keqpërdorime, mallverzime dhe presione të mëdha ndaj përkrahësve të kryetarit GI Serpska Narodna Sloga dhe kandidatit për kryetar komune Strahinja Spasiq. Ky presion është bërë nga drejtorë dhe zyrtar tjerë përmes institucioneve R. Serbisë, siç janë drejtor shkollash, drejtor spitalesh, kryetar komunash dhe drejtues të institucioneve të mirëqenies sociale dhe shumë institucione të tjera në të dy sistemet. Keqpërdorimet reflektoheshin në kërcënimin ndaj votuesve se nëse nuk vërtetohet se këta votues kanë votuar për Listën Serbe, do të largohen nga puna, duke shpallur konkurse të rreme që ata që kanë aplikuar të favorizohen për të votuar dhe në këmbim të punësohen duke dhënë kontrata për punë të përkohshme në numër të madh, në mënyrë që përfituesit e atyre kontratave të votojnë për Listën Serbe, duke ju ofruar ndihma afat shkurte edhe atyre që me ligj nuk ju takon e drejta për të votuar, vetëm për të votuar Listën Serbe. Më tutje parashtruesi i apelit ka theksuar se më datë 16 tetor 2021, në orët e mbrëmjes në Klllokot, në fshatin

Mogillë, nga Policia e Kosovës janë arrestuar katër persona të cilët me mjete monetare KESH blinin vota për listën Srpska, të cilët më pas janë akuzuar për veprën penale “Cenim i përcaktimit të lirë të votuesve” dhe “ Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin”. Andaj edhe parashtruesi i ankesës pretendon se zgjedhjet lokale për komunën e Klllokotit nuk janë mbajtur në frymë demokratike, se ka pasur keqpërdorime të mëdha dhe blerje votash nga Lista Serbe të cilat kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, për këto arsye PZAP-i duhet të anulohet votat e Listës Serbe dhe ta de certifikoj atë nga procesi zgjedhor. Apelit si dëshmi i ka bashkangjitur publikimin e portalit Info-Plus për arrestimet/ngritjen e aktakuzës në lidhje me votime.

PZAP lidhur me apelin Anr.725/2021, më datë 29.10.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje subjektit politik Lista Serbe, duke i dhënë afat për përgjigje, deri më datë 30.10.2021 në ora 9:00, mirëpo e njëjta deri në kohën e marrjes së këtij vendimi, nuk ka paraqitur përgjigje në apel.

Në përgjigje në apel KQZ-ja, ka theksuar se bazuar në Planin Operacional të KQZ-së, për ditën e Zgjedhjeve Lokale të datës 17.10.2021, KQZ-ja monitoron situatën e përgjithshme, përmes Dhomës Operative të saj, tërë procesin zgjedhor në nivel vendi, për të gjitha komunat, së bashku me përfaqësuesit e institucioneve nga KQZ, Policia dhe Prokuroria. Bazuar në raportet dhe ngjarjet e raportuara nga komunat e ndryshme në Dhomën Operative, rezulton se janë paraqitur nëntë raste të raportuara në komunat përkatëse, mirëpo gjatë tërë kësaj periudhe të funksionimit të Dhomës Operative të KQZ-së, nuk ka pasur asnjë njoftim, as informata dhe as raporte nga Komuna e Klllokotit, për ndonjë parregullsi apo incident të mundshëm gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor në këtë komunë. Për më tepër në këtë Dhomë Operative nuk është pranuar asnjë informatë, nga Menaxheret e QV-ve, Stafi Teknik ne QV, Kryesuesit apo Anëtarët e KVV-ve, Vëzhguesit, Anëtarët apo Trajnerët e KKZ-së, e as nga vet kryesuesi i KKZ-së, që në këtë komunë procesi zgjedhor është duke u penguar nga persona apo subjekte të ndryshme politike.

Paneli për të vërtetuar gjendjen faktike, vlerësoi provat si në vijim: Raportin e Policisë të datës 29.10.2021, Njoftimin e Prokurorisë së Shtetit dhe përgjigjen në apel të KQZ-së, e dhënë në formë raporti nga Dhoma Operative e KQZ-së.

Paneli, pasi që vlerësoi secilën nga provat një nga një, dhe të gjitha së bashku, gjeti se:

**Apeli është pjesërisht i bazuar, për këto arsye:**

Me Raportin e Policisë të datës 29.10.2021, Paneli vërtetoi se pretendimet që lidhen me procesin zgjedhor e që janë në lidhshmëri me rastin që është objekt i shqyrtimit, procedura penale ka filluar në drejtim të veprës penale “Cenim i përcaktimit të lirë të votuesve”, veprën penale e sanksionuar me nenin 210 të KPRK-së. Në raport është theksuar se në Komunën e Klllokotit, është ndaluar një veturë në të cilën ishin katër persona. tre të dyshuarit të cilët nëpërmjet veprimtarisë kriminale kanë arritur marrëveshje me të dyshuarin tjetër që këtij ti jepet shuma financiare në vlerë prej 200 €, në mënyrë që të votojë për kandidatin për kryetar komune nga Lista Serbe, në Komunën e Klllokotit.

Nga njoftimi i Prokurorit të Shteti, Paneli vlerësoi, se të pandehurit të paraqitur në këtë njoftim, i kanë dhënë 200.00 euro, me qëllim që të sigurohen 10 vota, për kandidatin për kryetar Komune të Klllokotit nga radhët e subjektit politik Lista Serbe.

Nga përgjigja në apel e KQZ-së, e dhënë në formë të raportit nga Dhoma Operative e KQZ-së, që është funksionale në ditën e votimit, në të cilën Dhomë Operative, paraqiten të gjitha parregullsitë eventuale gjatë procesit të votimit, paneli konstatoi se në këtë Dhomë Operative, nuk është pranuar asnjë informatë, nga Menaxheret e Qendrave të Votimit (QV), Stafit Teknik nëpër QV, Kryesuesit apo Anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve (KVV), Vëzhguesit, Anëtarët apo Trajnerët e Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), e as nga vet kryesuesi i KKZ-së, se në Komunën e Killokotit, procesi zgjedhor është penguar nga ndonjë person apo subjekte të ndryshme politike.

Paneli pas vlerësimit të secilës provë si më lart dhe të gjitha provave në tërësinë e tyre, vjen në përfundim se subjekti politik Lista Serbe, me veprimet e mbështetësve të saj e ka thyer Kodin e Mirësjelljes, duke ju premtuar votuesve shpërblime financiare me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve, që bie në kundërshtim me nenin 33 pika f) i LZP-së. Andaj paneli vendosi si në pikat -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohen me nenin 117 par. 3 të LZP-së, ku parashihet se: *“Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i, mbështetët në dëshmi të qarta dhe bindëse”* siç edhe ish-in në rastin konkret Raportit i Policisë së Kosovës i datës 29.10.2021 dhe Njoftimi i Prokurorisë së shtetit.

Paneli, pasi që erdhi në përfundim dhe përcaktoi, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 të LZP-së, se ka ndodhur shkelje e këtij ligji dhe rregullave të KQZ-së, nga ana e mbështetësve të subjektit politik Lista Serbe, në ditën e votimit të datës 17.10.2021, e që kanë ndikuar sipas ankuesit në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, paneli vlerësoi se në këtë rast është thyer Kodi i Mirësjelljes, për subjektet politike, në kuptim të nenit 33 pika f) i LZP-së. Andaj paneli vendosi një gjobë ndaj subjektit politik Lista Serbe, në lartësi prej 8,100.00 euro, siç është vendosur në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi. Kjo gjobë në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore-zgjedhore, dhe si të tilla cenojnë klimën e qetë dhe të përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar, si bazament i një procesi demokratik zgjedhor, për të cilën shkelje paneli mund të shqiptoi gjobë ndaj një subjekti politik, deri në 50,000.00 euro, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c) i LZP-së. Poashtu paneli me rastin e shqiptimit të gjobës, në këtë rast u mbështet edhe në rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli e mori faktin se subjekti politik Lista Serbe, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, dhe ka marrë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan gjobën e shqiptuar, brenda afatit të përcaktuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, atëherë në pajtim me nenin 120 paragrafi 2 të LZP-së, subjekti do të shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: *“Dështimi për të paguar dënimin apo për t'iu bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”*

Në raport me pikën -III- të dispozitivit për pjesën refuzuese, Paneli vlerëson se me asnjë nga provat e vlerësuara si më lart nuk është vërtetuar se është ushtruar ndonjë ankesë për ndonjë parregullsi në ndonjë vendvotim, po ashtu as në polici nuk është paraqitur ndonjë ankesë apo

kallëzim penal që ka të bëjë me presionin që iu është bërë votuesve në ditën e votimit nëpër vendvotime, e as në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve, prandaj nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të anuluar rezultatin vetëm për subjektin politik Lista Serbe, dhe të njëjtën për ta decertifikuar siç ka kërkuar ankuesi, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse se kishte parregullsi të asaj natyre në ditën e votimit që determinojnë marrjen e vendimit siç propozon parashtruesi i apelit. Për tu anuluar rezultati për një subjekt politik dhe i njëjti të decertifikohet nga gara zgjedhore, vërtetë duhet që gjatë procesit paraprak të votimit të jenë bërë shkelje zgjedhore shumë serioze në ditën e votimit, si rezultat i të cilave procesi i votimit dhe integriteti zgjedhor të jetë minuar seriozisht dhe që zgjedhjet të dalin me pa integritet. Qëndron fakti se të pandehurit të paraqitur në këtë njoftim, subjekti politik Lista serbe, i ka dhënë 200.00 euro, me qëllim që të sigurohen 10 vota, për kandidatin për kryetar Komune të Klllokotit nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, siç konstatohet në njoftimin e Prokurorisë së Shtetit, mirëpo Paneli vlerëson se vërtetë kemi të bëjmë me një rast të izoluar në këtë proces votimi dhe duke marrë parasysh se në pyetje janë vetëm 10 vota të blera në këtë mënyrë, për blerjen e të cilave ka prova të sigurta siç njofton Prokuroria e Shtetit, në njërin anë, dhe në anën tjetër se dallimi në vota në mes të këtij kandidati dhe kandidatit të subjektit politik Lista serbe është shumë më i madh se 10 vota, Paneli vlerëson se këto 10 vota kontestuese, janë pa ndikimin në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja.

Po ashtu paneli vlerëson se, pretendimet në ankesë, se kishte paraqitje të konkurseve të rrejshme për të ndikuar në aplikuesit që ata të ndikohen për votën e tyre, se kishte kontrata të lidhura të përkohshme për punë dhe se kishte dhënie të ndihmave afatshkurtra, përveç se janë theksuar në ankesën e parashtruara nuk janë mbështetur me asnjë provë konkrete për ta bërë të besueshme pretendimin e tillë që do të mund të vlerësohej si indikacion se ka ndikuar në përcaktimin e lirë të votuesve, andaj në mungesë të provave pretendimet e tilla janë të pabazuara.

Meqenëse në këtë rast është iniciuar procedura penale, sipas njoftimit të Prokurorisë së Shtetit, të vlerësuar më lart si provë, gjoba e shqiptuar në këtë rast në kuptim të nenit 120 paragrafi 5 të LZP-së, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksionimi penal që mund të pasojë, pasi që vendimet e PZAP-së, janë vendime administrative, dhe në asnjë rast nuk e paragjykon çështjen për zhvillimin e një procedure tjetër.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 dhe 120 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A.nr.725/2021 më datën 31.10.2021



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.